

<i>Albanian</i>	<i>English</i>
<p style="text-align: center;"><b>STATUT I</b> <b>SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË</b> <b>KUFIZUAR</b> <b>"The United Group"</b></p> <p>Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", - i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" – i ndryshuar, veprimtaria e shoqërisë do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Baza ligjore</b></p> <p>1.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin shqiptar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Ortakët e shoqërisë</b></p> <p>2.1 Ortakët e shoqërisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Z. Khaled Abdelaziz Abdelaziz Khamis</b> shtetas egjiptian, lindur në Cairo, më datë 26.10.1974, mbajtës i pasaportës me Nr. A28932450;</li> <li>• <b>Z. Ahmed Gamal Ahmed Afifi</b>, shtetas egjiptian, lindur në KWT (Kuwait), më datë 12.04.1982, mbajtës i pasaportës me Nr. A34414793.</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>STATUTE</b> <b>OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY</b> <b>"The United Group"</b></p> <p>Based on Law No. 9901 dated 14.04.2008 "On Traders and Commercial Companies" - amended, and Law No. 9723 dated 03.05.2007 "On Business Registration" - amended, the company's activities will be organized and directed according to the provisions of this Statute.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Legal Basis</b></p> <p>1.1 The company will conduct its activities in accordance with this Statute and Albanian legislation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Company Partners</b></p> <p>2.1 The partners of the company are:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mr. Khaled Abdelaziz Abdelaziz Khamis</b>, Egyptian citizen, born in Cairo on 26.10.1974, holder of passport No. A28932450;</li> <li>• <b>Mr. Ahmed Gamal Ahmed Afifi</b>, Egyptian citizen, born in KWT (Kuwait) on 12.04.1982, holder of passport No. A34414793.</li> </ul>

*Ahmed Afifi*  
*Khaled Khamis*

*Ahmed Afifi*  
*Khaled Khamis*

<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Forma ligjore</b></p> <p>3.1 Shoqëria ka formën e “shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar” ose “SHPK”. Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>Legal Form</b></p> <p>3.1 The company is a "limited liability company" or "LTD". However, it may be converted into another form in accordance with Albanian legislation.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Kohëzgjatja e veprimtarisë</b></p> <p>4.1 Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Duration of Activity</b></p> <p>4.1 The company's duration is <b>indefinite</b>, beginning from the date of its registration in the National Business Center's Trade Register.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Selia</b></p> <p>5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: <b>Rruga e Kavajës, Garden Building, Kati 11, Ap. 1A/11/2, Njësia Bashkiake Nr.7, Tiranë.</b></p> <p>5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Headquarters</b></p> <p>5.1 The company's headquarters is at: <b>Rruga e Kavajës Garden Building, 11th Floor, Apt. 1A/11/2, Municipality Unit No.7, Tirana.</b></p> <p>5.2 The company may open branches and/or representative offices within and outside the territory of the Republic of Albania and may participate in other Albanian and/or foreign companies that exist or will be established in the future.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Dokumentet e shoqërisë</b></p> <p>6.1 Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Company Documents</b></p> <p>6.1 All letters, forms, orders, or any other correspondence issued by the company, its branches, or representative offices, using paper or electronic means, directed to third parties, must contain, in addition to the company's name, the following information:</p>

Ahmed Afifi  
Chalid Des

Ahmed Afifi  
Chalid Des



<p>mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) numrin unik të identifikimit;</li> <li>b) formën ligjore të shoqërisë;</li> <li>c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;</li> <li>d) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;</li> </ul> <p>6.2 Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Objekti i veprimtarisë</b></p> <p>7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Shërbime imobilare, konsulencë për shitje dhe blerje, qiramarrje dhe qiradhënie;</li> <li>❖ Konsulencë në marrëdhënie të ndryshme biznesi, duke përfshirë por pa u kufizuar në, konsulencë në fushën e investimeve të huaja, menaxhimin e biznesit, marrëdhëniet ndërkombëtare. Konsulencë në përzgjedhjen dhe rekrutimin e stafit;</li> <li>❖ Import-eksport si dhe tregtimi i artikujve të ndryshëm ushqimor e industrial;</li> <li>❖ Aktivitet në fushën e farmaceutikës dhe bioteknologjisë.</li> <li>❖ Zhvillim, ndërtim dhe manaxhim i strukturave për turizëm, hoteleri, Bar-Restorant;</li> <li>❖ Shërbime marketingu, marketing dixhital, elektronikë dhe teknologji;</li> <li>❖ Organizim eventesh;</li> <li>❖ Pa u kufizuar në sa më sipër, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a) Unique identification number;</li> <li>b) Legal form of the company;</li> <li>c) Registered headquarters and central office location;</li> <li>d) Information if the company is in liquidation;</li> </ul> <p>6.2 If the company has a website, this information must be reflected there.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7:</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Object of Activity</b></p> <p>7.1 The company's activity will include:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Real estate services, consultancy for sale, purchase, lease, and rental;</li> <li>❖ Consultancy in various business relationships, including but not limited to foreign investment consultancy, business management, international relations consultancy. Staff selection and recruitment;</li> <li>❖ Import-export and trade of various food and industrial items;</li> <li>❖ Activity in the field of pharmaceuticals and biotechnology</li> <li>❖ Development, construction, and management of structures for tourism, hotels, bars, and restaurants;</li> <li>❖ Marketing services, digital marketing, electronics, and technology;</li> <li>❖ Event organization;</li> <li>❖ Without limiting the foregoing, the company may engage in any activity permitted and in accordance with the applicable legislation.</li> </ul>
---	---

Ahmed Afifi  
 Shabed Reis

Ahmed Afifi  
 Shabed Reis

7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

#### Neni 8

##### Kapitali themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është EUR 30,000 (tridhjetë mijë euro), ekuivalent i 3,000,000 lekë (tremilion lekë).

8.2 Kapitali ndahet në 2 (dy) pjesë/kuota.

8.3 Ortaku, Khaled Abdelaziz Abdelaziz Khamis, zotëron 50% të kapitalit themeltar, ose 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 15,000 EUR (pesëmbëdhjetë mijë euro), ekuivalent i 1,500,000 lekë (një milion e pesëqind mijë lekë).

Ortaku, Ahmed Gamal Ahmed Afifi, zotëron 50% të kapitalit themeltar, ose 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 15,000 EUR (pesëmbëdhjetë mijë euro), ekuivalent i 1,500,000 lekë (një milion e pesëqind mijë lekë).

#### Neni 9

##### Transferimi i pjesëve të kapitalit

9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.

9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

7.2 The company's activity object may be changed or added by the decision of the Assembly of partners.

#### Article 8:

##### Initial Capital

8.1 The initial capital of the company is EUR 30,000 (thirty thousand euros), equivalent to 3,000,000 ALL (three million lekë).

8.2 The capital is divided into 2 (two) parts/quotas

8.3 Partner Khaled Abdelaziz Abdelaziz Khamis owns 50% of the initial capital or 1 (one) quota with a nominal value of EUR 15,000 (fifteen thousand euros), equivalent to 1,500,000 ALL (one million five hundred thousand lekë);

Partner Ahmed Gamal Ahmed Afifi owns 50% of the initial capital or 1 (one) quota with a nominal value of EUR 15,000 (fifteen thousand euros), equivalent to 1,500,000 ALL (one million five hundred thousand lekë).

#### Article 9

##### Transfer of Capital Shares

9.1 The initial capital shares are freely transferable among partners. The initial capital is freely transferable in case of inheritance, in case of division of assets between spouses or between ancestors and descendants.

9.2 The initial capital shares are freely transferable to third parties, whether these are Albanian or foreign entities, physical or legal persons.

Ahmed Afifi  
Khaled Afifi

Ahmed Afifi  
Khaled Afifi



### Neni 10

#### Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

### Neni 11

#### Asambleja e Ortakëve

11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.

11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:

- ndryshimi i dispozitave të statutit,
- zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,
- emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
- miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,

### Article 10

#### Capital Increase/Reduction

10.1 The increase and reduction of the company's capital can be done by decision of the Assembly of partners, as well as in accordance with legal requirements.

10.2 Partners, at the simple request of the administrator, can unanimously and proportionally fulfill the company's financial needs through capital increase or financing (whether profitable/interest-bearing or not) by respecting banking transparency norms and other fiscal requirements. Reimbursement of partners' deposits and financings can be done by the decision of the partners, which can also be used to cover potential operational losses.

### Article 11:

#### Assembly of Partners

11.1 The Assembly of Partners consists of the company's partners. It is chaired by the company's administrator or any other person chosen by the partners.

11.2 The Assembly of Partners has the following main competencies:

- Amendment of the statute's provisions;
- Capital increase or reduction;
- Appointment and change of the administrator, liquidators, and accountant;
- Approval of the administrator's, liquidators', and accountant's remuneration;

Ahmed Afifi  
Chahed Ben

Ahmed Afifi  
Chahed Ben

- miratimi i llogarive vjetore (bilancit),
- ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,
- mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.

11.3 Asambleja e ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.

11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike por në çdo rast duhet të përmbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.

11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

#### Neni 12

##### Vendimmarrja

12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.

12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve

- Approval of annual accounts (balance sheet);
- Change of the company's legal form;
- Early closure and distribution of the company, as well as other matters defined in the current Albanian commercial legislation.

11.3 The Assembly of Partners meets at least once a year and whenever it needs to decide on matters within its competence. Meetings can also be held via video conference.

11.4 The Assembly is called by the Administrator or by partners representing at least 5% of the initial capital. The Assembly is called by a written notice sent to the partners at least seven days before the meeting date. The notice can also be sent via email but must contain the date, time, place, and agenda of the issues to be discussed.

11.5 Partners can be represented at the meeting by other persons based on a previously issued proxy.

#### Article 12

##### Decision Making

12.1 For decisions requiring a simple majority, the Assembly of partners can make valid decisions only if partners holding more than 30% of the company's capital participate.

12.2 For decisions requiring a qualified majority, the Assembly of partners can make valid decisions only if partners holding more than 50% of the company's

Ahmed Afifi  
Chalida

Ahmed Afifi  
Chalida



mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.

12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi i procesverbalit.

### **Neni 13**

#### **Administrator**

13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

13.2 Shoqëria drejtohet nga 1 administrator, i cili është:

- ❖ **Z. Khaled Abdelaziz Abdelaziz Khamis** shtetas egjiptian, lindur në Cairo, më datë 26.10.1974, mbajtës i pasaportës me Nr. A28932450.

13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë të

capital participate.

12.3 The Assembly decides with 75% of the participating capital (represented by partners) as provided in point 12.2 above for the amendment of the statute, capital increase and reduction, profit distribution, reorganization, and dissolution of the company. In other cases, the Assembly decides with more than 50% of the partners' votes participating in the meeting.

12.4 All Assembly decisions must be recorded in minutes, noting the date, place, agenda, name of the meeting chair and minutes taker, main issues, and decisions made. The minutes are signed by the minutes taker.

### **Article 13**

#### **Administrator**

13.1 The Administrator is appointed for a five (5) year term. The Administrator can be replaced or removed from this position by the decision of the Assembly of partners. The term is renewable.

13.2 The company is managed by 1 administrator:

- ❖ **Mr. Khaled Abdelaziz Abdelaziz Khamis**, Egyptian citizen, born in Cairo on 26.10.1974, holder of passport No. A28932450.

13.3 The Administrator, among other things, has the

*Ahmed Afifi*  
*Abdelaziz*

*Ahmed Afifi*  
*Abdelaziz*

<p>drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.</p> <p>13.4 Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.</p> <p>13.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.</p>	<p>right to: direct the company's daily activities, represent the company in relations with third parties, present proposals and reports to the Assembly of partners regarding the company's activities, open bank accounts in the company's name, and other rights recognized by law and the Assembly of partners.</p> <p>13.4 The Administrator, based on a decision of the Assembly of partners, can appoint directors, representatives with a proxy, and general mandataries for specific actions or categories of actions.</p> <p>13.5 The Administrator cannot sell and/or buy real estate in the company's name and on behalf of the company without prior written approval from the Assembly of partners.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Kontrolli financiar</b></p> <p>14.1 Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14:</b> <b>Financial Control</b></p> <p>14.1 The Assembly of Partners can appoint one or more accountants who are responsible for conducting the company's accounting and financial control.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Viti financiar</b></p> <p>15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.</p> <p>15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15:</b> <b>Financial Year</b></p> <p>15.1 The company's financial year coincides with the calendar year, starting from January 1 and ending on December 31 of each year.</p> <p>15.2 Exceptionally, the first financial year of the company's activity begins from its registration date</p>

Ahmed Afifi  
Dualed Qari

Ahmed Afifi  
Dualed Qari



Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 16**

**Bilanci dhe Dividendët**

16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.

16.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

**Neni 17**

**Likuidimi dhe prishja**

17.1 Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

**Neni 18**

**Dispozita mbyllëse**

18.1 Ky Statut hartohet në dy ekzemplarë me fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKËT**

**Khaled Abdelaziz Abdelaziz Khamis**

*Khaled Khamis Abdelaziz*

**Ahmed Gamal Ahmed Afifi**

*Ahmed Gamal Ahmed Afifi*

*Datë 08.07.2024*

in the National Registration Center's Trade Register.

**Article 16:**

**Balance Sheet and Dividends**

16.1 At the end of the financial year, the Administrator takes measures to prepare the balance sheet. The balance sheet is presented to the partners for approval within legal deadlines.

16.2 The Assembly of partners that approves the annual balance sheet decides on the distribution of profit to the partners or the creation of reserves, as well as the creation of legal reserves.

**Article 17:**

**Liquidation and Dissolution**

17.1 The liquidation and dissolution of the company are decided and carried out in accordance with legal requirements.

**Article 18:**

**Closing Provisions**

18.1 This Statute is drafted in two original copies with equal legal force.

**PARTNERS**

**Khaled Abdelaziz Abdelaziz Khamis**

*Khaled Khamis Abdelaziz*

**Ahmed Gamal Ahmed Afifi**

*Ahmed Gamal Ahmed Afifi*

*Date: 08.07.2024*

*Ahmed Afifi*

*Ahmed Afifi*